



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TEPELENË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr.183 prot.

Tepelenë, më 02.02. 2024

V E N D I M

Nr.1, datë. 31.01.2024

**PËR MIRATIMIN E NDIHMËS EKONOMIKE ME FOND 6% TË FONDIT TË
KUSHTËZUAR PËR MUAJIN DHJETOR 2023**

Në mbështetje të Ligjit Nr 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore " neni 21 të ligjit nr 57/2019 "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë" VKM nr 597 datë 04.09.2019" Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike" nr. 115/2021, "Për buxhetin e vitit 2023" Vendimit nr. 597, datë 04.09.2019 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e kriterëve të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike" i ndryshuar me vendimin nr 868 date 29.12.2021;

Vendimit të Këshillit Bashkiak Tepelenë nr.4 datë 31.01.2023 "Për miratimin e kriterëve, procedurave, dokumentacionit dhe sistemit të pikëzimit për përdorimin e fondit të kushtëzuar mbi programin e bllok- ndihmës ekonomike deri në 6% ose me fondet e buxhetit vendor" Këshilli Bashkiak pasi mori në shqyrtim materialin e përgatitur nga sektori i ndihmës ekonomike në mbledhjen e datës 31.01.2024

VENDOSI

1. Të përfitojnë ndihmë ekonomike 6% për muajin **Dhjetor 2023, 15** familje me fond **76251 lekë**, bashkëlidhur sipas tabelës.

+	EMER ATËSI MBIEMËR	NRANTARËVE NË FAMILJE	SHUMA
	BASHKIA E QYTETIT TEPELENË		
1	MAJLINDA EQEREM BAKO	2	3703
2	BUJAR VESEL METO	1	2178
3	ANULA KANAN MAMA	2	3703
4	JETNOR ZYBER ÇUNAJ	1	2178

5	ELTON BARJAM ÇELA	2	3267
6	MONIKA SAFET BETA	3	7920
7	MARSELA MYZAFER ISUFI	2	3703
8	BRUNILDA MYZAFER KERI	4	10692
9	ALMIRA ÇETI HAZBIA	1	2178
10	ROVENA ASTRIT RACO	4	10692
11	MELISA DULAJ	2	5940
12	BRUNILDA RIZA MAMAJ	2	3703
	SHUMA		59857
	NJESIA ADM. QËNDËR		
1	HEDO GOXHA	3	5227
2	ANDON SHUMELI	3	5227
	SHUMA		10454
	NJESIA ADM. KURVELESH		
	NJESIA ADM LOPËS		
1	KLODJANA ZENEL SULAJ	2	5940

	SHUMA		5940
		SHUMA TOTALE	76251

- Ngarkohet Drejtoria Ekonomike & Menaxhimit Financiar, Drejtoria Ligjore (sektori I ndihmës ekonomike), Njësitë Administrative të Bashkisë Tepelenë për ndjekjen e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Valbona ÇELA

Miraturar me 10 (dhjetë) vota
Vota Pro 10 (dhjetë)
Vota Kundër -
Vota Abstenim -
Zbardhur më datë 02.02.2024.

KRYETAR I KËSHILLIT

ARBEN GUMENI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA TEPELENË
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr.183/1 prot.

Tepelenë, më 02.02.2024

V E N D I M

Nr.2, datë 31.01.2024

PËR DHENIEN E NDIHMËS EKONOMIKE PËR PERDORIMIN E FONDIT TË BASHKISË PËR FAMILJET QE DO TE TRAJTOHEN ME NDIHMË EKONOMIKE PËR MUAJIN DHJETOR 2023.

Në mbështetje të ligjit nr 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" neni 21 të ligjit 57/2019, "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë" dhe VKM nr 597, datë 04.09.2019, "Për percaktimin e procedurave, dokumentacionit dhe masës mujore të perfitimit të ndihmës ekonomike dhe ërdorimit të fondit shtese mbi fondin e kushtëzuar për ndihmen ekonomike" VKB nr .95. datë 25.11.2022 "Për miratimin e buxhetit për vitin 2023", VKB nr. 4. Datë. 31.01.2023 "Për miratimin e kriterëve procedurave, dokumentacionit dhe sistemit të pikëzimit për përdorimin e fondit të kushtëzuar mbi programin e bllok ndihmës ekonomike deri 6% ose me fondet e buxhetit vendor " Këshilli i Bashkisë :

VENDOSI

- 1.Të trajtojë me ndihmë ekonomike 57 familje me fond 152.000 lekë. Bashkëlidhur tabela.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria ekonomike & menaxhimit financiar Sektori i Ndihmës Ekonomike dhe PAK, Drejtoria Ligjore, Njësitë Administrative të Bashkisë Tepelenë.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëhere.

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Valbona ÇELA

Miratuar me 10 (dhjetë) vota

Vota Pro 10 (dhjetë)

Vota Kundër -

Vota Abstenim -

Zbardhur më datë 02.02.2024

KRYETARI I KËSHILLIT

ARBEN GUMENI



BASHKIA TEPELENE

LISTE PAGESA E NDIHMES EKONOMIKE FONDE BASHKISE

DHJETOR 2023 F BASHKISE

Nr	Emri e Mbiemri				SHUMA GJITHSEJ	Nr.kartes ID	firmë
1	AGRON CAUSHI	3000			3000		
2	ARTUR ALIAJ	2000			2000		
3	AGRON BEGAJ	3000			3000		
4	SABRI CUNA	2000			2000		
5	MARJOLA GOXHARI	3000			3000		
6	FITNETE ILJAZI	3000			3000		
7	SIMJON CUNA	3000			3000		
8	MIKEL MECO	3000			3000		
9	NAFIE MULLARA	2000			2000		
10	MYZAFER LICAJ	3000			3000		
11	GJYLO MERJO	3000			3000		
12	KOSTANOVA BEJKO	2000			2000		
13	KUJTIM HAMZAI	2000			2000		
14	MECO HYSENAGARAJ	3000			3000		
15	RUDIN CUNAJ	3000			3000		
16	PETRIT KARAFILI	2000			2000		
17	VIKTOR SAKA	3000			3000		
18	QENDRIME RACO	2000			2000		
19	SHPETIM MUSARA	3000			3000		
20	GJOLEK AVDULI	2000			2000		
21	JETMIRA HALILI	3000			3000		
22	VELIKO GUMENI	3000			3000		
23	ERMAL CUNA	3000			3000		
24	KASTRIOT VARFA	3000			3000		
25	SHPRESA KASA	5000			5000		
26	ERIDA LEPURI	3000			3000		
	SHUMA	72000			72000		

ADMINISTRATORI SHOQEROR

Armand Sala

NJESIA QENDER

LISTE PAGESA E NDIHMES EKONOMIKE

DHJETOR 2023 F BASHKISE

Nr	Emri e Mbiemri				SHUMA GJITHSEJ	Nr.kartes ID	firmë
1	ISMET ZIA	3000			3000		
2	AGIM MUCOPATA	3000			3000		
3	FLAMUR GJYRDEDI	2000			2000		
4	FILE MUCA	2000			2000		
5	ILIR GERBI	3000			3000		
6	ILIR BODECI	3000			3000		
7	BLERTA GJOKTHOMI	2000			2000		
8	TATJANA HOXHA	2000			2000		
9	ARTAN SUNDA	3000			3000		
10	PERPARIM AHMETI	3000			3000		
11	DIAMANTA BALLIA	3000			3000		
12	KRISTINA RRAPI	3000			3000		
13	SADIK VARFI	3000			3000		
14	BUJAR BRAHO	2000			2000		
15	HASKO DURA	2000			2000		
16	NEXHMIJE XHEBRA	2000			2000		
17	HEROINA ZENELI	2000			2000		
18	AHMET BEQIRI	2000			2000		
19	FLORA XHEBRA	2000			2000		
20	VALDET SINORUKA	3000			3000		
21	PELLAGJI KUCA	3000			3000		
22	ADERIANA SALA	2000			2000		
23	JULIANA IMERA	3000			3000		
24	SKENDER VARFI	2000			2000		
25	KLODIAN BALLIA	2000			2000		
	SHUMA	62000			62000		

ADMINISTRATOR SHOQEROR
ROVENA MULLARA

NJESIA KURVELESH

LISTE PAGESA E NDIHMES EKONOMIKE

DHJETOR 2023 F BASHKISE

Nr	Emri e Mbiemri				SHUMA GJITHSEJ	Nr.kartes ID	
1	BANUSH META	3000			3000		
2	DASHO KUCA	3000			3000		
3	ALFRED LENA	3000			3000		
4					0		
5					0		
6					0		
7					0		
8					0		
9					0		
10					0		
11					0		
12					0		
	SHUMA	9000	0	0	9000		

ADMINISTRATOR SHOQEROR

PAOLA DEMIRI

NJESIA LOPES

LISTE PAGESA E NDIHMES EKONOMIKE

DHJETOR 2023 F BASHKISE

Nr	Emri e Mbiemri				SHUMA GJITHSEJ	Nr.kartes ID	firme
1	MATJOLA ZERAJ	3000			3000		
2	PELLUMB IMERAJ	3000			3000		
3	AXHEM HASANI	3000			3000		
					0		
5					0		
6					0		
7					0		
8					0		
9					0		
10					0		
11					0		
12					0		
13					0		
	SHUMA	9000	0	0	9000		

ADMINISTRATOR SHOQEROR

FESTIME ELEZI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA TEPELENË
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr.183/2prot.

Tepelenë, më 02.02.2024.



**“MIRATIMI I KRITEREVE, PROCEDURAVE, DOKUMENTACIONIT DHE SISTEMIT
TË PIKËZIMIT PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË KUSHTËZUAR MBI PROGRAMIN
E BLOK-NDIHMËS EKONOMIKE DERI NË 6 PËR QIND OSE ME FONDET E
BUXHETIT VENDOR”.**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronjat “a” dhe “b”, nenit 24, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, nenit 21, të ligjit nr. 57/2019, “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, Kreut IV, pika 1, të vendimit nr. 597, datë 04.09.2019, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, të ndryshuar, të Këshillit, me propozimin e kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I :

1. Të miratojë kriteret mbi përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën Ekonomike deri në 6 për qind, dhe fondet e bashkisë si më poshtë:

1.1. Familjet në nevojë do të përzgjidhen nga lista e familjeve që kanë aplikuar brenda tre muajve të fundit nëpërmjet Regjistrat Elektronik Kombëtar për ndihmën ekonomike dhe të cilat nuk janë shpallur fitues nga sistemi i pikëzimit për pamjaftueshmëri pikësh.

1.2. Do të përzgjidhen ata aplikues që kanë paraqitur dosje të plotë dokumentacioni.

1.3 Prioritet do të kenë familjet me nevoja social-ekonomike të theksuar:

a. familje të cilat sigurojnë të ardhura të pamjaftueshme dhe në përbërje të tyre kanë të mitur.

b. familje me 1 (një) anëtar,

c. vajza/gra kryefamiljare të divorcuara/të veja me fëmijë në ngarkim,

d. kryefamiljar që me vendim gjykatë kanë në ngarkim fëmijë të mitur,

e. familje me më shumë se 4 (katër) anëtarë, ose me shumë dhe në përbërje të tyre kanë të mitur.

f. kryefamiljar te braktisur

2. Të miratojë **dokumentacionin mbi përdorimin** e fondit të kushtëzuar për bllok ndihmën ekonomike deri në 6% ose me fondet e buxhetit vendor, si më poshtë:

- a. Vlerësim Social Ekonomik.
- b. Fletë përmbledhje e daljes nga sistemi pikëzimit.
- c. Vërtetim KMCA.
- d. Fotokopje e çertifikatës familjare
- e. Fotokopje e kartës së identitetit.
- f. fotokopje libreze zyra e punës

3. Të miratojë **sistemin e pikëzimit** mbi përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok ndihmën ekonomike deri në 6% ose me fondet e buxhetit vendor, sipas aneksit nr.1, bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij.

4. Familjet e përzgjedhura do të përfitojnë ndihmën ekonomike nga programi i bllok-ndihmes 6% ose fondi i vënë në dispozicion nga Bashkia Tepelene në programin e kujdesit social projekti "Mbrotja sociale për kategorinë e familjeve në nevojë të përjashtuara nga skema e ndihmës ekonomike" në buxhetin e vitit 2024.

Nuk mund të trajtohen:

a) familjet të cilat nuk kanë aplikuar për ndihmë ekonomike sipas vendimit nr. Vendimit nr. 597, datë 4.09.2019 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e kriterëve të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike";

b) familjet të cilat trajtohen me ndihmë ekonomike sipas vendimit nr. Vendimit nr. 597, datë 4.09.2019 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e kriterëve të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike"

5. Ngarkohen Drejtorisë Arsimit Sportit Kujdesit Shoqëror /Sektori I Ndihmës ekonomike dhe Njësitë Administrative të Bashkisë Tepelene për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

6. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar si dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Gjirokastrë.

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Valbona ÇELA



Miratuar me 10 (dhjetë) vota

Vota Pro 10 (dhjetë)

Vota Kundër -

Vota Abstenim -

Zbardhur më datë 02.02.2024.

KRYETARI I KËSHILLIT

ARBEN GUMENI



1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18	19	20	21	22	23	24	25	26	27	28	29	30	31	32	33	34	35	36	37	38	39	40	41	42	43	44	45	46	47	48	49	50	51	52	53	54	55	56	57	58	59	60	61	62	63	64	65	66	67	68	69	70	71	72	73	74	75	76	77	78	79	80	81	82	83	84	85	86	87	88	89	90	91	92	93	94	95	96	97	98	99	100
---	---	---	---	---	---	---	---	---	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	-----

0

0

VLERESIMI SOCIAL EKONOMIK

PIKEZIMI

GJENDJA FAMILJARE

ME FEMIJE NEN 18 VJEC 10 PIKE
ME FEMIJE MBI 18 VJEC 5 PIKE
IVE/DIVORCUAR/VECUAR 10 PIKE
PAK K/FAMILJAR 10 PIKE
PAK FAMILJAR 5 PIKE
cdo antar familje 2 pike

FAMIJE RURALE 5 PIKE

FAMILJE URBANE 5 PIKE

ME PASURI PALUAJTSHME 5 PIKE

PA PASURI PALUAJTSHME 10 PIKE



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TEPELENË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr.183/4 prot.

Tepelenë, më 02.02.2024

V E N D I M

Nr.4, datë. 31.01.2024

“Për miratimin e vendgroposjeve të kafshëve për Bashkinë Tepelenë”

Në mbështetje të nenit 8 “Ushtrimi i autoritetit me interes publik vendor” dhe të nenit 9 “Të drejtat dhe përgjegjësitë”, ligjit nr.139/2015 “Per vetqeverisjen vendore”; ligjit 115/2014 “Per ndarjen administrativo territoriale te njesive te qeverisjes vendore ne Republiken e Shqiperise” i ndryshuar; ligjit nr.8743 date 22.02.2001 “Per pronat e paluajtshme te shtetit”, ligjit 57/2020 “Për pyjet; ligjit nr.9693 datë 19.03.2007 “Për fondin kullor” te ndryshuar; Ligjit nr.10465, date 29.9.2011 “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar; VKM nr.475, datë 30.07.2021 “Për bashkëpunimin e njësive të vetqeverisjes vendore me shërbimin veterinar”; shkresat e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr.4047/8 datë 01.08.2022, nr.818/47 datë 4.10.2022, nr.3210 datë 02.06.2023, dhe nr.30 datë 8.1.2024; sipërfaqet e propozuara nga Njësitë Administrative bëjnë pjesë në njësitë administrative Kurvelesh, Lopës, dhe Qendër Tepelenë;

V E N D O S I:

1. Të miratoj vendet e propozuara për groposjen e kafshëve në Njësitë Administrative të Bashkisë Tepelenë sipas legjislacionit në fuqi.
2. Këto pasuri bëjnë pjesë në territorin e Bashkisë Tepelenë Njësitë Administrative Kurvelesh, Sinanaj, Qendër si më poshtë:

Nr.	Nj.A/Fshati	Nr. Kadastral	Zona Kadastrale	Lloji
1	Kurvelesh/ Nivicë	565	2807	Pa frut
2	Kurvelesh/ Gusmar	362	1913	Pa frut
3	Kurvelesh/ Progonat	887	3057	Pa frut
4	Kurvelesh/ Lekdush	602	2404	Pa frut
5	Lopës/ Dhëmbjan	326	1480	PF/Kullotë
6	Qendër/ Luzat	205	2541	PF/Kullotë

3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr. 139/2015 për “Vetëqeverisjen vendore” dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Gjirokastrë.

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Valbona ÇELA



Miraturar me 10 (dhjetë) vota
Vota Pro 10 (dhjetë)
Vota Kundër -
Vota Abstenim -
Zbardhur më datë 02.02.2024.

KRYETARI I KËSHILLIT





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA TEPELENË
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr.183/5 prot.

Tepelenë, më. 02.02.2024

V E N D I M

Nr.5, datë. 31.01.2024

“Për miratimin e venddepozitimit të mbetjeve inerte për Bashkinë Tepelenë”

Në mbështetje të nenit 8 “Ushtimi i autoritetit me interes publik vendor” dhe të nenit 9 “Të drejtat dhe përgjegjësitë”, ligjit nr.139/2015 “Per vetqeverisjen vendore”; ligjit 115/2014 “Per ndarjen administrativo territoriale te njesive te qeverisjes vendore ne Republiken e Shqiperise” i ndryshuar; ligjit nr.8743 date 22.02.2001 “Per pronat e paluajtshme te shtetit”; Ligjit Nr.10 463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” të ndryshuar; VKM Nr. 575, datë 24.6.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”; VKM Nr. 452, datë 11.7.2012 “për lëndfillet e mbetjeve”, të ndryshuar; sipërfaqja e propozuara bënë pjesë në njësinë administrative Qendër Tepelenë, fshati Luzat;

V E N D O S I:

1. Të miratoj venddepozitimin e mbetjeve inerte në Njësinë Administrative Qendër Tepelenë në pasurinë nr.59 ZK2541 e regjistruar kullotë sipas ASHK Tepelenë dhe tokë pa frut sipas gjendjes kadastrale të vitit 1991 nga ZAMT Tepelenë sipas dokumentacionit bashkëlidhur.
2. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr. 139/2015 për “Vetëqeverisjen vendore” dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Gjirokastrë.

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Valbona ÇELA

Miratuar me 10 (dhjetë) vota
Vota Pro 10 (dhjetë)
Vota Kundër -
Vota Abstenim -
Zbardhur më datë 02.02.2024.

KRYETAR I KËSHILLIT

ARBEN GUMENI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA TEPELENË
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr.183/3 prot.

Tepelenë më, 02.02.2024

V E N D I M

Nr.6, datë 31.01.2024

P Ë R

PRANIM NË SHTEPINË E TË MOSHUARVE GJIROKASTËR

Këshilli i Bashkisë në mbledhjen e tij të datës 31.01.2024, në mbështetje të ligjit 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore” neni 54, Ligjit nr.121, datë 21.11.2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.518, datë 04.09.2018 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar” pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Kujdesit Social

V E N D O S I:

- 1.Të miratojë kërkesën e paraqitur nga qytetari: Zenel Sinani banor i Njesisë Adminsitrative Tepelenë, për t’iu dhënë e drejta e kalimit në Shtepinë e të moshuarve Gjirokastër për strehim, si banor i Qarkut Gjirokastër.
2. Dokumentacioni të kalojë në Shtepinë e të moshuarve Gjirokastër.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Bashkia Tepelenë dhe Drejtoria e Kujdesit Social.
4. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Valbona ÇELA

Miratuar me 10 (dhjetë) vota

Vota Pro 10 (dhjetë)

Vota Kundër -

Vota Abstenim -

Zbardhur më datë 02.02.2024.

KRYETAR I KËSHILLIT

ARBEN GUMENI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA TEPELENË
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr.183/8 prot.

Tepelenë më, 02.02.2024

V E N D I M

Nr.7, datë 31.01.2024

PËR

PRANIM NË SHTEPINË E TË MOSHUARVE GJIROKASTËR

Këshilli i Bashkisë në mbledhjen e tij të datës 31.01.2024, në mbështetje të ligjit 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore” neni 54, Ligjit nr.121, datë 21.11.2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.518, datë 04.09.2018 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar” pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Kujdesit Social

V E N D O S I:

- 1.Të miratojë kërkesën e paraqitur nga qytetari: Dilaver Isara, banor i Njësisë Adminsitrative Tepelenë, për t’iu dhënë e drejta e kalimit në Shtepinë e të moshuarve Gjirokastër për strehim, si banor i Qarkut Gjirokastër.
2. Dokumentacioni të kalojë në Shtepinë e të moshuarve Gjirokastër.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Bashkia Tepelenë dhe Drejtoria e Kujdesit Social.
4. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Valbona ÇELA

Miratuar me 10 (dhjetë) vota
Vota Pro 10 (dhjetë)
Vota Kundër -
Vota Abstenim -
Zbardhur më datë 02.02.2024.

KRYETAR I KËSHILLIT

ARBEN GUMENI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TEPELENË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr.183/7 prot.

Tepelenë, më 02.02.2024

V E N D I M

Nr. 8, datë. 31.01.2024

“Për azhurnimin e hartës kadastrale për pasurinë nr.7/4 ZK 1529 ndodhur në fshatin Dragot, Bashkia Tepelenë”

Në mbështetje të Ligjit nr.139/2015 “Për vetqeverisjen vendore” të ndryshuar; Ligjit nr.115/2014 “Për ndarjen administrative-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar; Ligjit nr.8743 date 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit” te ndryshuar; Ligjit 8744 date 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme të shtetit në njësitet e qeverisjes vendore” të ndryshuar; VKM nr. 510, datë 10.06.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara e të patrupëzuara”; VKM 843 datë 6.12.2011 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose përdorim të komunës Qendër Tepelenë, të Qarkut Gjirokastrë”; VKM 433/2016 të ndryshuar; mbështetur në të dhënat e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (ASHK) statusi juridik i pasurive;

V E N D O S I:

1. Azhurnimin e hartës kadastrale për pasurinë nr.7/4 ZK1529 fshati Dragot, të llojit “Kullotë” e cila është pjesë e nënngastrës 73b të Ekonomisë Pyjore Dragot, pronë e Bashkisë Tepelenë, dhe përdorimin e kësaj pasurie për rrugë për lidhjen e rrugës kryesore me parcelat bujqësore private, sipas planvendosjes bashkëngjitur këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr. 139/2015 për “Vetëqeverisjen vendore” dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Gjirokastrë.

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Valbona ÇELA

Miratuar me 10 (dhjetë) vota
Vota Pro 10 (dhjetë)
Vota Kundër -
Vota Abstenim -
Zbardhur më datë 02.02.2024.

KRYETARI I KËSHILLIT



PLAN RILEVIMI PER PUNIME KADASTRALE

PRONARI: BASHKIA TEPELENE

DATE 29.01.2024

QELLIMI: PER IFORMACION

VENDNDODHJA: TEPELENE

BASHKIA TEPELENE DVAKSH/ZVAKSH BBBBZONA KADASTRALE: 1529 NUMURI PASURISE 7/4-A INDEKS HARTE:K-34-137-35-A

TE DHENAT E PASURISE

LLOJI I PASURISE :KULLOTE


SIP.PASURISE = 287 m²

SIP. GJURMES NDERTIMIT= m²

NR. KATEVE

NR.PEMEVE

KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE



SHK. 1:2500

Nr.	ORIENTIMI	PERDORIMI	TIPI KUFIRIT	KUFITARI	ID/NIPT	SHENIME TE REALIZUESIT
1	VERIU		KUFI TOKESOR			
2	JUGU					
3	LINDJA					
4	PERENDIMI					

REALIZOI

MAKSIM SHEHU

LICENCA NR. T.0025/3

Data: 21 .06. 2017

NENESHKRI

REALIZOI PER ASHK

SPECIALISTI

DV ASHK

NENSHKRIMI

KONFIRMOI

PËRGJEGJËSI/DREJTORI

NENSHKRIMI/VULA

TEKNOLOGJIA E MATJEVE T, Z, D,O.

Kode për teknologjinë e matjeve: T-Terren; Z-Zyrë; O-Ortofoto; G-GPS; S-Stacion Total; D-Matje Distancash

PËRCAKTIMI I KUFIRIT HK

Kode për përcaktimin e kufirit: P- Përfaqësues i Pronarëve; K- Kufitarët të Gjithë; KP-Kufitarët Pjesërisht;

PB-Përfaqësues Bashkie; HK- Harta Kadastrale

SHËNIME TË VECANTA:

PASURIA 7/4-A MARRE NGA PASURIA 7/4-KULLOTE ME SIP= 287m²

FRAGMENTI I HARTES ESHTË MARRE NGA HARTA KADASTRALE 1:5000-KODER-LEKE

PASURIA 7/4-A PROPOZOHET PER RRUGE SI SERVITU KALIMI PER NE PARCELEN 16.

PASURIA 7/4, BENE PJESE EDHE NE NGASTREN 73/b TE EKONOMISE PYJORE DRAGO

PRONARI/BASHKEPRONARET-DEKLARIMI MBI MARREDHENIET ME KUFITARET

EMRI : BASHKIA TEPELENE

NENESHKRIMI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TEPELENË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 1 prot.

Tepelenë, më 31.01.2024

PROCESVERBAL

(I zbardhur nga origjinali)

I mbajtur sot, më datë 31.01.2024, ora 10:00 në sallën e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak Tepelenë në mbledhjen e radhës të Këshillit Bashkiak Tepelenë thirrur nga Kryetari i Këshillit në bazë të Neni 53, Pika 3, Germa a, Pika 4 e Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, si dhe “Rregullores së funksionimit të Këshillit Bashkiak” me këtë rend dite:

- Miratimi i rendit të ditës së mbledhjes.
- Për miratimin e procesverbalit të mbledhjes së kaluar, datë 21.12.2023.
- **Projektvendim:** “Për miratimin e ndihmës ekonomike me fond 6% të fondit të kushtëzuar për muajin Dhjetor 2023”.
- **Projektvendim:** “Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të Bashkisë për familjet që do të trajtohen me ndihmë ekonomike për muajin Dhjetor 2023”.
- **Projektvendim:** “Për miratimin e kriterëve, procedurave, dokumentacionit dhe sistemit të pikëzimit për përdorimin e fondit të kushtëzuar mbi programin e bllok-ndihmës ekonomike deri në 6 % ose me fondet e buxhetit vendor”.
- **Projektvendim:** “Për miratimin e vend-groposjes së kafshëve”.
- **Projektvendim:** “Për miratimin e vend depozitimit të mbetjeve inerte”.
- **Projektvendim:** “Për pranim në shtëpinë e të moshuarve Gjirokastër”.
- **Projektvendim:** “Për miratim, kërkesë për shprehje interesi për shitjen e një apartamenti në qytetin e Tepelenës e cila është në pronësi të degës rajonale Gjirokastër të EKB-së”.
- Informacion nga Komisariati i Policisë Tepelenë “Mbi ruajtjen e rendit dhe qetësisë publike në territorin e Bashkisë Tepelenë”.
- Çështje të tjera.

N/Kryetare e Këshillit Bashkiak Znj. Mjaftoni Zeraj drejton mbledhjen.

Ora e hapjes së mbledhjes 10:10

Këshilltarë pjesëmarrës në momentin e hapjes së mbledhjes:

- Latif Kaçaj
- Mirela Varfi
- Mjaftoni Zeraj
- Matilda Çela
- Vladimir Bakiaj
- Esmeralda Bishani
- Ilir Haska
- Besnik Meçe
- Vladimir Gjonca
- Ditar Hodaj

Marrin pjesë nga Administrata e Bashkisë:

- Julinda Karteri
- Gëzim Shehu
- Festime Elezi
- Rovenë Mullara

N/Kryetare e Këshillit Znj. Mjaftoni Zeraj deklaroi hapjen e mbledhjes, paraqet rendin e ditës dhe dy P/Vendime jashtë rendit të ditës, të paraqitura nga aparati i Bashkisë.

Këshilltarët shprehin dakortësinë me rendin e ditës, dhe miratimin e një p/vendimi të paraqitur nga aparati i Bashkisë, “Për azhurnimin e hartës kadastrale për pasurinë nr. 7/4 Z.K. nr. 1529, ndodhur në fshatin Dragot, Bashkia Tepelenë”.

N/Kryetare e Këshillit deklaroi hapjen e votimit për miratimin e rendit të ditës.

Vota PRO: 10

Latif Kacaj, Mirela Varfi, Mjaftoni Zeraj, Matilda Çela, Vladimir Bakiaj, Vladimir Gjonca, Ilir Haska, Esmeralda Bishani, Ditar Hodaj, Miftar Meta

Vota KUNDËR: S’ka

Vota ABSTENIM: S’ka

- **Pika e dytë e rendit të ditës:** “Miratimin e procesverbalit të mbledhjeve të kaluara datë 21.12.2023”

N/Kryetare e Këshillit u drejton pyetje këshilltarëve, në lidhje me procesverbalin e mbledhjes së kaluar.

Këshilltarët shprehin dakortësinë me përmbajtjen e procesverbalit.

N/Kryetare e Këshillit deklaron hapjen e votimit për miratimin e procesverbalit të mbledhjes së kaluar. Votimi i hapur

Vota PRO :10

Latif Kacaj, Mirela Varfi, Mjaftoni Zera, Matilda Çela, Vladimir Bakiaj, Vladimir Gjonca, Ilir Haska, Esmeralda, Bishani, Ditar Hodaj, Miftar Meta

Vota KUNDËR: S’ka

Vota ABSTENIM: S’ka

- **Pika e tretë e rendit të ditës:** “Për miratimin e ndihmës ekonomike me fond 6% të fondit të kushtëzuar për muajin Dhjetor 2023”

N/Kryetare e Këshillit deklaron shqyrtimin e projektvendimit.

Fjalën e mori Znj, Matilda Çela Kryetare Komisionit Ekonomisë: - Komisioni u mbledh u njoh me materialin dhe vendosi miratimin e ndihmës ekonomike me fond 6% për muajin Dhjetor 2023.

N/Kryetare e Këshillit deklaron hapjen e votimit për miratimin e këtij projektakti.

-Votimi i hapur

Vota PRO: 10

Latif Kacaj, Mirela Varfi, Mjaftoni Zera, Matilda Çela, Vladimir Bakiaj, Vladimir Gjonca, Ilir Haska, Esmeralda, Bishani, Ditar Hodaj, Miftar Meta

Vota KUNDËR: S’ka

Vota ABSTENIM: S’ka

- **Pika e katërt Projektvendim:** “Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të Bashkisë për familjet që do të trajtohen me ndihmë ekonomike për muajin Dhjetor 2023”.

N/Kryetare e Këshillit deklaroi shqyrtimin e projektvendimit.

Fjalën e mori Znj. Matilda Çela Kryetare Komisionit Ekonomisë: - Komisioni u mbledh, u njoh me materialin dhe vendosi miratimin e ndihmës ekonomike me fondin e bashkisë, për muajin Dhjetor 2023.

Fjalën e mori Këshilltarja Znj. Esmeralda Bishani: - Jam dakort që këto familje të trajtohen me fondin e bashkisë, por në muajin Gusht - Shtator këto familje nuk janë trajtuar me ndihmë ekonomike nga fondi i Bashkisë.

Administrator Shoqëror Njësia Adm. Qendër, Znj. Rovenë Mullara: - Deri në muajin Gusht janë trajtuar të gjitha këto familje, pastaj shkëputje për dy muaj. Ka filluar trajtimi me fond të Bashkisë në muajin Nëntor, Dhjetor 2023.

Fjalën e mori Z. Miftar Meta: - Kam një shqetësim në Njësinë Administrative Kurvelesh, zyra e administratorit shoqëror ka një ngatërresë me gjendjen civile, të gjitha dosjet e Njësisë Administrative Kurvelesh, të personave që trajtohen me PAK vijnë në Njësinë Qendër, zyra nuk ofron asnjë shërbim.

Kemi vënë në djeni Kryetarin e Bashkisë, Administratorin e Njësisë, të zgjidhet kjo problematikë. Drejtore Ligjore Znj. Julinda Karteri: - Kemi dy zyra gjendje civile në Bashkinë Tepelenë, qyteti dhe Njësia Administrative Qendër. Ne do verifikojmë ku qëndron problemi dhe do t'ju përcjellim zyrtarisht një përgjigje.

N/Kryetare e Këshillit deklaroi hapjen e votimit për miratimin e këtij Projektakti.

-Votimi i hapur

Vota PRO: 10

Latif Kacaj, Mirela Varfi, Mjaftoni Zeraj, Matilda Çela, Vladimir Bakiaj, Vladimir Gjonca, Ilir Haska, Esmeralda Bishani, Ditar Hodaj, Miftar Meta

Vota KUNDËR: S'ka

Vota ABSTENIM: S'ka

➤ **Pika e pestë e rendit të ditës Projektvendim:** “Për miratimin e kriterëve, procedurave, dokumentacionit dhe sistemit të pikëzimit për përdorimin e fondit të kushtëzuar mbi programin e bllok-ndihmës ekonomike deri në 6 % ose me fondet e buxhetit vendor”.

Fjalën e mori Znj. Matilda Çela Kryetare Komisionit Ekonomisë: - Komisioni u njoh me materialin dhe vendosi miratimin e kriterëve, ju po të keni ndonjë pikë tjetër për të shtuar në lidhje me kriteret e ndihmës ekonomike mund ta shtojmë në material.

N/Kryetare e Këshillit znj. Mjaftoni: Ka pyetje? - Jo

N/Kryetare e Këshillit deklaroi hapjen e votimit për miratimin e këtij projektvendimi.

➤ Votimi i hapur

Vota PRO: 10

Latif Kacaj, Mirela Varfi, Mjaftoni Zera, Matilda Çela, Vladimir Bakiaj, Vladimir Gjonca, Ilir Haska, Esmeralda, Bishani, Ditar Hoda, Miftar Meta

Vota KUNDËR: S'ka

Vota ABSTENIM: S'ka

➤ **Pika e gjashtë e rendit të ditës. Projektvendim:** “Për miratimin e vendgroposjes së kafshëve”

Fjalën e mori Drejtori Zhvillimit Rural Z. Gëzim Shehu: - Paraqet materialin (bashkëlidhur)

-Në bashkëpunim me njësitë Administrative kemi kërkuar propozime për vendgroposjen e kafshëve. Kemi 6 propozime, 4 në Njësinë Administrative Kurvelesh, 1 në Njësinë Administrative Qëndër, 1 në Njësinë Administrative Lopës. Këto vende zgjidhen jashtë zonave të banuara, toka të pafrytshme sipas zonave kadastrale.

Fjalën e mori Z. Latif Kacaj: - Zonat e përcaktuara çfarë kushte dhe kritere duhet të plotësojnë?

Fjalën e mori Drejtore Ligjore Znj. Julinda Karteri: - Cilat janë kriteret në bazë të ligjit?

Fjalën e mori Drejtori Zhvillimit Rural Z. Gëzim Shehu: - Këto vende janë jashtë qendrave të banuara, larg rrjedhjes ujore, larg staneve dhe bagëtie.

Fjalën e mori Z. Latif Kacaj: - Zona e Lopësit është zonë e infektuar, duhet kujdes, është zonë e kuqe fshati Dhëmban.

N/Kryetare e Këshillit Znj. Mjaftoni: - Me çfarë materiali do ndërtohen? Do jenë gropa skeptike të thjeshta?

Fjalën e mori Drejtori Zhvillimit Rural Z. Gëzim Shehu: - Këto vende do bëhen në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural sipas kritereve që ka ligji në fuqi.

Fjalën e mori Z. Ditar Hodaj: - Në njësinë Administrative Kurvelesh në fshatin Nivicë, Rexhin të vendoset vendi Dilan.

Fjalën e mori Drejtori Zhvillimit Rural Z. Gëzim Shehu: - Ishte propozim nga Njësia Administrative Kurvelesh për vendin e quajtur “Poporave”, është hequr nuk plotëson kriteret dhe është vendosur për të dy fshatrat Rexhinë dhe Nivicë, në vendin e quajtur “Dilan”.

N/Kryetare e Këshillit Znj. Mjaftoni: - Ka pyetje? - Jo

N/Kryetare e Këshillit deklaroi hapjen e votimit për miratimin e këtij projektvendimi.

-Votimi i hapur

Vota PRO: 10

Latif Kacaj, Mirela Varfi, Mjaftoni Zeraj, Matilda Cela, Vladimir Bakiaj, Vladimir Gjonca, Ilir Haska, Esmeralda, Bishani, Ditar Hodaj, Miftar Meta

Vota KUNDËR: S'ka

Vota ABSTENIM: S'ka

➤ **Pika e shtatë e rendit të ditës:** “Për miratimin e venddepozitimit të mbetjeve inerte”.

Fjalën e mori Drejtori Zhvillimit Rural Z. Gëzim Shehu: Paraqet materialin bashkëlidhur

-Kemi propozuar tokë të pafrytshme në fshatin Luzat, me nr. pasurie 59 ZK 2541, e cila është larg zonave të banuara dhe terreni është në formë grope e cila do të mbushet dhe do të rehabilitohet.

Fjalën e mori Z. Ditar Hodaj: - Ka probleme me pronarët?

Fjalën e mori Drejtori Zhvillimit Rural Z. Gëzim Shehu: - Jo është tokë shtet e pafrytshme.

N/Kryetare e Këshillit Znj. Mjaftoni: -Ka pyetje ? - Jo

N/Kryetare e Këshillit deklaroi hapjen e votimit për miratimin e këtij Projektakti.

➤ Votimi i hapur

Vota PRO: 10

Latif Kacaj, Mirela Varfi, Mjaftoni Zeraj, Matilda Cela, Vladimir Bakiaj, Vladimir Gjonca, Ilir Haska, Esmeralda, Bishani, Ditar Hodaj, Miftar Meta

Vota KUNDËR: S'ka

Vota ABSTENIM: S'ka

Fjalën e mori Z. Ditar Hodaj: - Vendi i mbetjeve urbane në qytet ku është?

Fjalën e mori Drejtori Zhvillimit Rural Z. Gëzim Shehu: - Është në lagjen Majkosh, vendi i miratuar në vitin 1988, është bërë projekt për mbyllje, pritet financim nga Ministria e Mjedisit për të bërë mbylljen dhe ndërtimin e stacionit të transferimit i cili nuk është përcaktuar ose aty ku është ose në fshatin Veliqot.

Drejtoresh Ligjore Znj. Julinda Karteri: - Vjosa Park Kombëtar, të vë kushte në lidhje me higjienën, do të bëhet ruajtje natyrore e lumit, do të bëhen projekte për mbrojtjen dhe trajtimin e ujërave të zeza.

Fjalën e mori Znj. Mirela Varfi: - Mbetjet urbane në fshatin Dukaj çfarë shërbimi ofrohet?

Drejtoresh Ligjore Znj. Julinda Karteri: - Fshati Dukaj mbulohet me shërbimin e grumbullimit të mbetjeve me dy makina një qyteti, një makinë njësitë administrative.

Fjalën e mori Znj. Mirela: - Në fshatin Dukaj shërbim ofrohet në qendër të fshatit. Lagjja Kordhaj, nuk ka shërbim për mbetjet.

N/Kryetare e Këshillit Znj. Mjaftoni: - Ka pyetje? - Jo

N/Kryetare e Këshillit deklaron hapjen e votimit për miratimin e këtij projektvendimi.

-Votimi i hapur

Vota PRO: 10

Latif Kacaj, Mirela Varfi, Mjaftoni Zera, Matilda Çela, Vladimir Bakiaj, Vladimir Gjonca, Ilir Haska, Esmeralda, Bishani, Ditar Hodaj, Miftar Meta.

Vota KUNDËR: S'ka

Vota ABSTENIM: S'ka

N/Kryetare Këshillit Znj. Mjaftoni: - Të vazhdojmë me pikën tjetër meqenëse drejtori është këtu.

Drejtor Zhvillimi Rura Z. Gëzim Shehu: - Materiali që ju paraqitëm sot në këshill për azhurnimin e hartës kadastrale për pasurinë nr.7/4 ZK1529 ndodhur në fshatin Dragot Njësia Administrative Qëndër, Bashkia Tepelenë. Azhurnimi i hartës kadastrale për këtë pasuri nr 7/4 zk 1529 në fshatin Dragot të llojit kullotë dhe përdorimin e kësaj pasurie për rrugë për lidhjen me rrugën kryesore me parcelat bujqesore private sipas planvendosjes bashkëlidhur këtij p/vendimi.

Fjalën e mori Z. Latif Kacaj: - Ka konflikt në fshat?

Gëzimi: - Jo

N/Kryetari i Këshillit deklaron hapjen e votimit për miratimin e këtij Projektvendimi.

-Votimi i hapur

Vota PRO: 10

Latif Kacaj, Mirela Varfi, Mjaftoni Zera, Matilda Çela, Vladimir Bakiaj, Vladimir Gjonca, Ilir Haska, Esmeralda, Bishani, Ditar Hodaj, Miftar Meta.

Vota KUNDËR: S'ka

Vota ABSTENIM: S'ka

➤ **Pika e tetë e rendit të ditës:** “Për pranim në shtëpinë e të moshuarve Gjirokastrë”

Drejtoresh Ligjore Znj. Julinda Karteri: Jeni njohur me materialin, qytetari banor i Bashkisë Tepelenë ka paraqitur dokumentacionin dhe kërkesën për tu akomoduar në shtëpinë e të moshuarve Gjirokastrë.

N/Kryetare Këshillit Znj. Mjaftoni: Ka pyetje? Jo

N/Kryetare e Këshillit deklaroi hapjen e votimit për miratimin e këtij Projektvendimi.

-Votimi i hapur

Vota PRO: 10

Latif Kacaj, Mirela Varfi, Mjaftoni Zera, Matilda Çela, Vladimir Bakiaj, Vladimir Gjonca, Ilir Haska, Esmeralda, Bishani, Ditar Hodaj, Miftar Meta

Vota KUNDËR: S'ka

Vota ABSTENIM: S'ka

Fjalën e mori Z. Ditar Hodaj: -Në mbledhjen e Këshillit të muajit Dhjetor është marrë vendim nga këshilli për heqjen e tabelave në rrugën Ali Pasha, i është përcjellë komisarit të policisë?

Drejtoresh Ligjore Julinda Karteri: - Nuk kam marrë vendim të zbardhur, ka ardhur si shqetësim nga këshilli, administrata nuk është përfshirë.

Fjalën e mori Z. Ditar Hodaj: - Administrata nuk na ka pyetur ne, ju bëtë veprim të paligjshëm për vendparkimet.

Fjalën e mori Z. Latif Kacaj: -Ka pasur vendim të mëparshëm për tabelat, të shfuqizohet vendimi, nuk është bërë vendim për heqje tabelash.

N/Kryetare Këshillit Znj. Mjaftoni: - Kemi votuar për heqje tabelash, por p/vendim nga aparati i Bashkisë nuk ka ardhur.

Fjalën e mori Z. Ditar Hodaj: - Tabelat janë hequr pa vendim këshilli.

➤ **Pika e nëntë e rendit të ditës:** “Për miratim kërkesë për shprehje interesi për shitjen e një apartamenti në qytetin e Tepelenës e cila është në pronësi të degës rajonale Gjirokastrë të EKB-së”

Drejtoresh Ligjore Znj. Julinda Karteri: - Në Bashkinë Tepelenë nga EKB-së Gjirokastrë është vënë në dispozicion një banesë me nr. pasurie 22/42+1-18/1 ndodhur në Njësine Administrative Tepelenë, lagja Demokraci. Në mbështetje të ligjit 22/2018 “Për strehimin social”, komisioni i strehimit na ka përcjellë për miratim në këshill emrin e një familjeje përfituese për apartamentin e përmendur më sipër. Sektori i strehimit ka shqyrtuar dokumentacionin e paraqitur, kërkesën e një qytetari për këtë banesë e cila është Melisa Dulaj, banore e Bashkisë Tepelenë.

Sektori i emergjencave civile ka bërë një vlerësim të gjithë familjeve të pastreha në Bashkinë Tepelenë të cilat trajtohen me ndihmë ekonomike, bonus qiraje etj,. Është një rast që plotëson kriteret, e divorcuar me një fëmijë. Duke u mbështetur në vendimarrjen që ka marrë KB për pikëzimin e shtresave në nevojë, kjo familje është në pararojë të familjeve të tjera.

Fjalën e mori Z. Ditar Hodaj:- Mos të kalojë në këshill derisa vendos EKB-së Gjirokastrë, të diskutohet në mbledhjen tjetër, të bëhen njoftimet dhe në njësitet Administrative ka raste më keq se ky rast.

Drejtoresh Ligjore Znj. Julinda Karteri: - Ky rast i përket kategorisë më të ndjeshme. Njoftimet janë bërë nga sektori i strehimit. Ne kemi certifikatën e pronësisë së EKB-së, sipas ligjit 22/2018 që thotë, “të gjitha banesat të cilat janë në pronësi në inventar të EKB-së, pa u certifikuar nuk mund t’u jepen Bashkive për të vendosur, për të marrë një emër, sepse kontrata bëhet me EKB-në, ne nuk bëjmë këtë proces, ky proces bëhet nga EKB”, por banesa ndodhet në Bashkinë Tepelenë, është EKB, që bën procedurën e shitjes.

Përsa i përket pjesës së njoftimit, kërkesa është bërë nga qytetari, Sektori i emergjencave civile ka gjykuar se është në listën e të pastrehëve në Bashkinë Tepelenë, trajtohet me bonus qiraje, është një rast që plotëson kriteret një familje në nevojë për tu strehuar.

Fjalën e mori Z. Vladimr Bakia: - Ka shumë familje si kjo në nevojë.

Fjalën e mori Z. Ditar: - Të shtyhet procedura të bëhen shpalljet në çdo njësi administrative.

N/Kryetare Këshillit Znj. Mjaftoni: -Të shqyrtohet kjo çështje, informacion më i plotë, të shqyrtohet në mbledhjen e radhës.

➤ **Pika e dhjetë e rendit të ditës:** Informacion nga Komisariati i Policisë Tepelenë “Mbi ruajtjen e rendit dhe qetësisë publike në territorin e Bashkisë Tepelenë.

N/Kryetare Këshillit Znj. Mjaftoni: - Materiali ka ardhur nga sekretari, duhet të jetë një përfaqësues i komisaritit të policisë, nuk e diskutojmë këtë pikë.

Fjalën e mori Z. Vladimr Bakiaj: - N.q.s. nuk ka përfaqësues nga komisariati i policisë, në mbledhjen e radhës të paraqitet një përfaqësues nga Komisariati i Policisë

➤ **Çështje të tjera.**

- Kërkesë nga qytetari Myzafer Ballaxhia (bashkëlidhur kërkesa)

Drejtoresh Ligjore Znj. Julinda Karteri: - Qytetari nuk e ka çuar procedurën e banesës deri në fund, kanë marrë kontratë dhe nuk kanë vazhduar procedurën më tutje për 32 vjet. Personi i është drejtuar Këshillit, dhe ju do jeni pjesë e vendimmarrjes kur të plotësohen të gjitha dokumentet sepse kemi një ngërç, ka lidhje me pasuritë e paluajtshme, pasi në bazë të ligjit për pasuritë e patundshme, këto pasuri në nuk i kemi në listën e inventarit. Unë i jam drejtuar ASHK por është procedurë e gjatë

- Kërkesë nga Z. Çeti Hazbia për Riparim çatie (bashkëlidhur kërkesa)

Drejtoresh Ligjore Znj. Julinda Karteri: - Në bazë të ligjit për informimin publik, këto ankesa-kërkesa ju i shqyrtoni, sekretari i kthen përgjigje qytetarit, kërkesa juaj u trajtua në mbledhjen e këshillit bashkiak.

Fjalën e mori Z. Ditar Hodaj: - Të shikohet kjo çështje, mund të jetë emergjente, të kalojë në komision të vlerësohet.

Fjalën e mori Znj. Matilda Çela: - Ne ja përcjellim kërkesën Bashkisë dhe në mbledhjen e radhës informacion për çështjen.

N/Kryetare Këshillit Znj. Mjaftoni: - Ankesë drejtuar Kryeministrit nga Z. Fatmir Çela (bashkëlidhur ankesa)

Fjalën e mori Z. Ditar Hodaj: - Sipas ligjit mund të bëhet rivotim, mund të vejë i dytë i zgjedhur pa bërë zgjedhje, mund të komandojë Kryetari i Bashkisë deri në zgjedhjen e një personi tjetër?

Drejtoresh Ligjore Znj. Julinda Karteri: - Kryetari i Bashkisë ka detyrim ligjor për të komanduar një person deri në zgjedhjen e K/Fshatit, por procesi i zgjedhjes së K/Fshatit është përgjegjësi e këshillit bashkiak, ju do vendosni çfarë do bëni në fshatin Turan.

Fjalën e mori Z. Ditar Hodaj: - Deri në zgjedhjet e reja, Kryetari Bashkisë të komandojë K/Fshati

Fjalën e mori Znj. Matilda Çela: - Të rrëzohet vendimi i parë, të përsëriten zgjedhjet në fshatin Turan.

Hidhet në votim, miratohet 10 vota **PRO**

Drejtoresh Ligjore Znj. Julinda Karteri: - Pranë Bashkisë akt inspektimi nga komisioneri për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale, në lidhje me ankuesit banorë të fshatit Mezhgoran të cilët kanë kërkuar t'ju vihen në dispozicion informacione dhe dokumentacion. (për dijeni Këshilli)

Me vendimin nr. 2, datë, 09.01.2024, Komisioneri për të drejtën e informimit ka sugjeruar rishikim, rivlerësim të paketës fiskale, saktësisht pasqyra 3, të tjera e tarifave vendore të shërbimit

për Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, dhënia e informacionit dhe ose vënien në dispozicion të dokumentacionit fizik, tërheqjen fizike të dokumentacionit nga arkivi i drejtorisë (njehsimi me origjinalin). Ne si administratë ju përcjellim këtë kërkesë me vlerësimin që ju do të ndryshoni në paketë zërat përkatës, por duke pasur parasysh që vlera e tarifës do të përkthehet me punën e një nëpunësi. Ju lutem vlerësoni këtë sugjerim.

Këshilltarët vlerësojnë sugjerimin, por nuk e quajnë të arsyeshme të ndryshojnë tarifën. Nuk do të ketë ndryshim në paketën fiskale jemi dakord me këtë paketë.

Mbyllet mbledhja e Këshillit Bashkiak ora 12:15

SEKRETARE E KËSHILLIT
Valbona Çela

KRYETAR I KËSHILLIT
Arben Gumeni